

Përgatitur për  
AOS - Albanian Ornithological Society

Nëntor 2023

Nga: Qendra "Res Publica"

# RAPORT

## MBI PRAKTIKAT

### MË TË MIRA GJYQËSORE PËR

## ZONAT E MBROJTURA



## **TABELA E PËRMBAJTJES**

|             |                                                                                                                                                             |           |
|-------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>I.</b>   | <b>HYRJE .....</b>                                                                                                                                          | <b>3</b>  |
| <b>II.</b>  | <b>PRAKTIKAT E KOMISIONIT EVROPIAN DHE GJYKATËS<br/>EVROPIANE PËR DREJTËSI (LUKSEMBURG) PËR GARANTIMIN E<br/>BIODIVERSITETIT NË ZONAT E MBROJTURA .....</b> | <b>4</b>  |
| <b>III.</b> | <b>PRAKTIKA GJYQËSORE NDËRKOMBËTARE .....</b>                                                                                                               | <b>9</b>  |
| <b>IV.</b>  | <b>PRAKTIKA VENDASE.....</b>                                                                                                                                | <b>15</b> |
| <b>V.</b>   | <b>NË VEND TË KONKLUZIONEVE.....</b>                                                                                                                        | <b>15</b> |
| <b>VI.</b>  | <b>BIBLIOGRAFIA.....</b>                                                                                                                                    | <b>15</b> |

## I. HYRJJE

Raporti është përgatitur nga konsulentja ligjore Dr. Av. Irena Dule si produkt kontraktor për shoqatën AOS - Albanian Ornithological Society, në kuadër të zbatimit të projektit "*Green AL*". Ky projekt mbështetet nga Co-Plan, me fonde të Mbretërisë së Suedisë, udhëhiqet nga AOS, në partneritet me Qendrën "*Eco Albania*" dhe Qendrën ligjore "*Res Publica*".

Zonat e Mbrojtura, gëzojnë një mbrojtje të lartë dhe status të vecantë edhe në legjislacionin tonë, në krahasim me pjesë të tjera të territorit. Kjo vjen për shkak të rëndësisë së tyre në këto aspekte:

- Ndihmojnë në ruajtjen e diversitetit të ekosistemeve, llojeve dhe varieteteve gjenetike dhe proceseve ekologjike, të cilat janë thelbësore për mbështetjen e jetës në tokë;
- Sigurojnë shërbime dhe të mira jetësore nga natyra dhe mbështesin mënyrën e jetesës së njerëzve duke përfshirë ujin, ajrin e pastër, klimën dhe burimet biologjike, si dhe vlerat estetike dhe shpirtërore;
- Kanë një vlerë mjaft të rëndësishme si përfaqësuese të jetës së egër të botës, si përmbledhëse të zonave të jashtëzakonshme të pasurisë së gjallë, për ruajtjen e vlerave të rëndësishme kulturore dhe peisazhistike;
- Shpesh janë strehë për njerëz me kultura tradicionale e njohuri të pazëvendësueshme mbi natyrë;
- Mund të jenë modele të përdorimit të qendrueshëm të burimeve që mund të aplikohen edhe në zona të tjera;
- Kanë vlera të pafundme shkencore, edukative, kulturore, rekreative dhe shpirtërore.<sup>1</sup>

Mekanizmi kryesor që legjislacioni shqiptar, por edhe ndërkombëtar i ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, për mbrojtjen e mjedisit natyror dhe shëndetit të njerëzve, duke mundësuar menaxhim efektiv mjedisor dhe përdorim të qendrueshëm të mjedisit në funksion të zhvillimit është respektimi nga ana e vendimarrjes publike të kriterëve ligjore që parashikon ky legjislacion.

Në rast të mosrespektimit të këtij legjislacioni mekanizmi tjetër më i rëndësishëm dhe që mund të garantojë mbrojtje efektive është sfidimi i vendimarrjes në rrugë gjyqësore.

Praktikat administrative dhe shkencore për këto zona janë të pasura. Nuk mund të themi të njëjtën gjë për praktikën gjyqësore brenda dhe jashtë vendit.

Në vijim, prezantojmë disa raste studimi të praktikave më të mira gjyqësore për garantimin e funksionimit dhe ruajtjes së zonave të mbrojtura, që vijnë nga vende në zhvillim, nga vendi jonë dhe nga praktika e Gjykatës Evropiane për Drejtësi dhe Komisioni Evropian.

---

<sup>1</sup> Vlerësimi i mangësive në zonat e mbrojtura, biodiversiteti detar dhe legjislacioni për zonat e mbrojtura detare", UNDP, Ministria e Mjedisit, GEF, Fq 13, <http://mcpa.iellearn.org/arshiva/analiza-e-mnagesive-ne-zm/analiza-e-mangesive>

## **II. PRAKTIKAT E KOMISIONIT EVROPIAN DHE GJYKATËS EVROPIANE PËR DREJTËSI (LUKSEMBURG) PËR GARANTIMIN E BIODIVERSITETIT NË ZONAT E MBROJTURA**

Në vijim jepen disa praktika të Komisionit Evropian me shtete anëtare të pëzgjedhura për efekt të këtij studimi sipas direktivave të BE-së që synojnë të mbrojnë habitatet dhe shpendët, pjesë e zonave të mbrojtura.

Në parantezë shpjegohet se si funksionon dhe vepron Komisioni Evropian në lidhje me këto çështje.

Komisioni ka fuqinë të ndërmarrë veprime juridike kundër një shteti anëtar që nuk respekton detyrimet e tij, sipas ligjit të Komunitetit, sipas nenit 258 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian.

Procedura e shkeljes fillon me një paralajmërim të parë me shkrim ("Letër e njoftimit zyrtar") drejtuar Shtetit Anëtar në fjalë, i cili duhet të përgjigjet brenda dy muajve.

Nëse Komisioni nuk është i kënaqur me përgjigjen, njoftimi zyrtar mund të pasohet nga një paralajmërim me shkrim përfundimtar ("Opinion i argumentuar") i cili shpjegon qartë shkeljen, dhe duke i bërë thirrje Shtetit Anëtar që të respektojë brenda një periudhe të caktuar, zakonisht dy muaj.

Mosveprimi i paralajmërimit me shkrim përfundimtar mund të rezultojë në një thirrje në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë (Gjykata e Luksemburgut). Nëse Gjykata vendos kundër Shtetit Anëtar, atëherë ky i fundit duhet të marrë masat e nevojshme për të zbatuar kërkesat e vendimit.

Nëse, pavarësisht vendimit, një Shtet Anëtar ende nuk arrin të veprojë në përputhje me të, fillon një raund i mëtejshëm i procesit, sipas nenit 260 të Traktatit, por këtë herë me vetëm një paralajmërim me shkrim. Raundi i dytë përfundimisht mund të rezultojë në ndëshkime financiare për Shtetin Anëtar në fjalë.

Në vijim paraqesim disa çështje të prezantuara para Gjykatës së Drejtësisë Evropiane nga ana e Komisionit Evropian kundër shteteve anëtare të BE ku janë gjetur shkelje të Direktivës së shpendëve.

### **2.1.Komisioni Evropian i kërkon Hungarisë dhe Rumanisë të sigurojnë mbrojtjen e habitateve të jetës së egër.<sup>2</sup>**

Më 31 Maj 2012, Komisioni i kërkoi Hungarisë dhe Rumanisë të përmirësojnë mbrojtjen e habitateve. Të dy shtetet kishin lejuar aktivitete ose zhvillime në vende me ndjeshmëri mjedisore pa bërë më parë një vlerësim të duhur të impaktit në mjedis.(zonë e mbrojtur) Mbi rekomandimin e Komisionerit të Mjedisit, Komisioni nisi një opinion të arsyetuar Hungarisë dhe një tjetër opinion të arsyetuar Rumanisë ku i kërkoi atyre të implementonin në mënyrën e duhur legjislacionin për mbrojtjen e habitateve. Nëse Hungaria dhe Rumania dështonin të zbatonin sa më sipër brenda dy muajve, Komisioni mund të referonte këtë çështje në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë.

---

<sup>2</sup> [https://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-12-539\\_en.htm?locale=en](https://europa.eu/rapid/press-release_IP-12-539_en.htm?locale=en)

Në rastin e Hungarisë ankesa kishte të bënte me prerjen e papërshtatshme të pemëve në pyllin 'Sár-éger' – pjesë integrale e faqes Natura 2000 'Csaholc-Garbolc'- që rezultoi në humbje të ndjeshme të habitatit prioritar. Pas komunikimit me autoritetet Hungareze, Komisioni doli në përfundimin se ato nuk kishin bërë një Vlerësim të Ndikimit në Mjedis në mënyrën e duhur para kësaj veprimtarie dhe as nuk kishin marrë masa për të kompensuar dëmet që do të shkaktoheshin.

Në këtë rast u shkel direktiva e habitateve e cila është krijuar mbështetur në dy shtylla: (1) Rrjeti i Natyra 2000 të zonave të mbrojtura dhe (2) një sistem strikt të mbrojtjes së specieve. Çdo vend anëtar ka dizenuar faqen *Natura 2000* në ndihmë të konservimit të specieve dhe habitateve të rralla, të pranishme në territorin e tyre.

Në rastin e Rumanisë, autoritetet dështuan të bënin një Vlerësim të Ndikimit në Mjedis të plotë dhe gjithëpërfshirës për një investim turistik të miratuar në Sulina në Detin e Zi. Komisioni i dërgoi Rumanisë një njoftim zyrtar në Maj 2010. Përgjigja e Rumanisë nuk mbuloi të gjitha shqetësimet e Komisionit dhe letra u ndoq nga opinion i parë i arsyetuar në Janar 2011. Sqarime të mëtejshme u kërkuar për procedurën e aplikimit pasi konstatoheshin elementë kontradiktorë në dokumentacionin shoqërues, veçanërisht në versionin përfundimtar të studimit të ndikimit të investimit në habitatet e mbrojtura. Direktiva e Habitaveve mbron mbi 1000 kafshë dhe specie dhe mbi 200 tipe habitatesh të tilla si tipe të ndryshme pyjesh, livadhesh dhe ligatinash me rëndësi Evropiane Mbi 25.000 zona janë përfshirë në rrjetin Natura 2000, që mbulon zona substanciale; pothuajse 1/5 e tokës në Evropë dhe një pjesë të rëndësishme të detit që e rrethon. Disa janë të vendosura në zona të largëta por shumë krijojnë pjesë integrale të fshatrave dhe përmbajnë lloje të ndryshme habitatesh, zona zbutëse të impaktit dhe elementë të tjerë të peizazhit.

## **2.2.Komisioni Evropian i kërkon Maltës respektimin e Direktivës së Shpendëve<sup>3</sup>**

Më 27 Shkurt 2012, Komisioni i kërkoj Maltës të përmirësonte mbrojtjen e shpendëve që bllokohen në ishull gjatë vjeshtës. Që kur Malta iu bashkua Bashkimit Evropian në 2004, lejoi shtegtimin e katër llojeve shpendësh që mbroheshin nga ligjet e Bashkimit Evropian: turtulli, shkurta, gjelaci pikalosh ngjyrë ari dhe tusha këngëtare. Sipas rekomandimit të Komisionerit të Mjedisit, Komisioni dërgoi një opinion të arsyetuar duke i kërkuar Maltës që të implementojë legjislacionin e mbrojtjes së shpendëve. Nëse Malta dështonte të përgjigjej brenda dy muajve, Komisioni mund të çojte çështjen para Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Në Evropë një pjesë e madhe e shpendëve mbrohen nga Direktiva e Shpendëve, dhe bllokimi me metodat në shkallë të gjerë ose me mënyrë joselektive të kapjes, siç janë rrjetat, janë përgjithësisht të ndaluara dhe mund të praktikohen ligjërisht vetëm mes shmangies nga respektimi i Direktivës. Përrjashtime mund të ketë vetëm nëse nuk ka një alternativë të zbatueshme, nëse shteti anëtar respekton kushtet dhe kërkesat e rrepta të përcaktuara në nenin 9 të Direktivës, dhe nëse mund të provojë para Komisionit që e kanë bërë një gjë të tillë.

Në Qershor 2011 Komisioni i dërgoi Maltës një njoftim zyrtar për zbatimin e gabuar të shmangieve që lejojnë bllokimin e shpendëve. Komisioni konsideroi që Malta dështoi të paraqesë prova të mjaftueshme për të vërtetuar se veprimet e saj për të ulur bllokimin respektonin të gjitha kushtet e nevojshme të Direktivës dhe në veçanti rregullat në lidhje me:

---

<sup>3</sup> [https://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-12-171\\_en.htm?locale=en](https://europa.eu/rapid/press-release_IP-12-171_en.htm?locale=en)

(1) Sigurimin se gjuetia lejohet për vetëm një numër të vogël të shpendëve; (2) Fokusin selektiv të zbatuar nga ulja e bllokimit; (3) Monitorimin strikt të kushteve të bllokimit.

Në përgjigjen e tyre drejtuar Komisionit, autoritetet e Maltës kontestuan ankesën e Komisionit dhe insistuan se kushtet për aplikimin e uljes së bllokimit ishin respektuar. Në 2011 Malta gjithashtu ndryshoi uljen e bllokimit në mënyrë që të zbatohej për vetëm një specie, për tushën këngëtare. Komisioni sërish vlerësoi se Malta dështoi në sjelljen e provave të mjaftueshme për të mbështetur kundërshtimet e saj dhe aplikoi uljen e bllokimit, përfshirë të fundit në vjeshtë 2011 në mënyrë jo korrekte. Në këto kushte Komisioni i nisi një opinion të arsyetuar.

### **2.3. Komisioni Evropian dërgon Bullgarinë në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë për dështim në mbrojtjen e specieve në rrezik zhdukjeje<sup>4</sup>**

Rajoni i Kaliakra, i vendosur në bregdetin e Detit të Zi në Bullgari është një vend i rëndësishëm për ruajtjen e llojeve të shumta të shpendëve dhe habitateve të tyre dhe, në përputhje me rrethanat, u caktua një IBA (Zonë e Rëndësishme për Shpendët) nga organizata joqeveritare BirdLife International.

Më 18 dhjetor 2007, në përputhje me Direktivën e Shpendëve, Republika e Bullgarisë përcaktoi Kaliakrën si një ZVM (Zonë e Veçante e Mbrojtur). Sidoqoftë, ajo zonë e mbrojtur përfshinte vetëm dy të tretat e territorit të Kaliakra IBA. Republika e Bullgarisë gjithashtu përcaktoi si ZVM edhe Belite Skali në përfundim të ZVM Kaliakra dhe jashtë IBA Kaliakra. Për më tepër, Bullgaria i propozoi Komisionit që një sipërfaqe Trualli me Interes të Komunitetit (SCI) të ideohet me emrin "Kompleksi Kaliakra" duke përfshirë pothuajse të gjithë zonën e mbuluar nga ZVM-të Kaliakra dhe Belite Skali.

Pas ankesave të paraqitura nga Shoqata Bullgare për Mbrojtjen e Shpendëve (Bulgarsko Druzhestvo za Zashtita na Ptitsite) në lidhje me shtrirjen e pamjaftueshme të zonës gjeografike të mbuluar nga ZVM Kaliakra dhe efektet e pafavorshme të disa projekteve për biznes në habitatet natyrore dhe habitatet e specieve të shpendëve, Komisioni i dërgoi një njoftim zyrtar më 6 qershor 2008 Bullgarisë duke kërkuar që ajo të shqyrtojë mospërmbushjen e detyrimeve të saj sipas nenit 4 (1) dhe (2) të Direktivës së Shpendëve në lidhje me gjashtë zonat ZVM, përfshirë këtu zonën SPA të Kaliakra. Meqenëse Komisioni nuk ishte i kënaqur me përgjigjet e ndryshme të paraqitura nga Bullgaria, ai dërgoi një njoftim zyrtar më 1 dhjetor 2008 duke i kërkuar Bullgarisë të korrigjojë mos përmbushjen e detyrimeve të saj sipas nenit 4 (4) të këtij ligji. Direktiva e Shpendëve dhe dispozitat e kombinuara të neneve 2 (1) dhe 4 (2) dhe (3) të Direktivës 2011/92 dhe të Shtojcës III të saj, aq sa Shteti Anëtar kishte autorizuar instalimin e disa turbinave të erës brenda zones IBA së Kaliakra. Bullgaria iu përgjigj këtyre njoftimeve zyrtare më 30 janar 2009 dhe më pas paraqiti informata shtesë në disa raste.

Më 30 shtator 2011, Komisioni dërgoi një njoftim të tretë zyrtar për Republikën e Bullgarisë, e cila, së pari, synonte të konsolidonte dy njoftimet zyrtare të mëparshme dhe së dyti, përmbante kërkesa të reja në lidhje me territoret IBA të Kaliakras, ZVM Belite Skali dhe SCI Kompleksi Kaliakra. Ky njoftim ngrii dy grupe çështjesh: hapësirën e pamjaftueshme gjeografike të territorit të ZVM Kaliakra dhe efektet e disa projekteve në ZVM Kaliakra, ZVM

---

<sup>4</sup> [https://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-13-966\\_en.htm](https://europa.eu/rapid/press-release_IP-13-966_en.htm)

Belite Skali, SCI Kompleks Kaliakra dhe zonën që duhej të klasifikohet si ZVM, sipas inventarit të IBA, por që nuk ishte klasifikuar si e tillë.

Më 30 Janar 2012, Bullgaria informoi Komisionin se projektet e listuara prej saj ishin aprovuar, në pjesën më të madhe, përpara hyrjes së këtij Shteti Anëtar në Bashkimin Evropian ose para përfshirjes së zonave në fjalë në rrejtin Natura 2000, dhe si rezultat ligji i BE-së nuk ishte i zbatueshëm për ato zona.

Me njoftimin e 22 qershorit 2012, Komisioni dha një mendim të arsyetuar në të cilin u ankua se Bullgaria kishte dështuar në përmbushjen e detyrimeve të saj sipas nenit 4 (1), (2) dhe (4) të Direktivës së Shpendëve, neni 6 (2), (3) dhe (4) të Direktivës së Habitave dhe dispozitave të kombinuara të neneve 2 (1) dhe 4 (2) dhe (3) të Direktivës 2011/92 (Direktiva e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis) dhe të Shtojcës III të saj.

Bullgaria iu përgjigj këtij mendimi të arsyetuar dhe, në bazë të informacionit shtesë, e informoi Komisionin se kishte marrë një seri masash të përcaktuara për të korrigjuar mangësitë e identifikuara.

Ndërsa e vlerësoi situatën si të pakënaqshme, Komisioni ndërmori veprimin e radhës, dërgimin e çështjes në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë, në 24 Mars 2014.

Gjykata Evropiane pasi e shqyrtoi çështjen deklaroi se:

- duke mos përfshirë të gjitha territoret e zonave të rëndësishme të shpendëve në zonën e veçantë të mbrojtjes që mbulon rajonin Kaliakra, Republika e Bullgarisë nuk ka arritur të klasifikojë si zona të posaçme mbrojtjeje, territoret më të përshtatshme në numër dhe madhësi për ruajtjen, së pari, të specieve biologjike të listuara në Shtojcën I të Direktivës 2009/147/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 30 nëntorit 2009 për ruajtjen e shpendëve të egër dhe, së dyti, të specieve migratore që nuk janë shënuar në atë aneks, por që levizin rregullisht në ato zona gjeografike e detit dhe tokës ku zbatohet kjo direktivë, me rezultatin që ai Shtet Anëtar nuk ka përmbushur detyrimet e tij sipas nenit 4 (1) dhe (2) të asaj direktive;
- duke miratuar zbatimin e projekteve 'AES Geo Energy', 'Disib' dhe 'Longman Investment' në territorin e zonës së rëndësishme të shpendëve që përfshin rajonin Kaliakra i cili nuk u klasifikua si zonë e veçantë e mbrojtur, megjithëse do të duhej të ishte, Republika e Bullgarisë nuk ka përmbushur detyrimet e saj sipas nenit 4 (4) të Direktivës 2009/147;
- duke miratuar zbatimin e projekteve 'Kaliakra Ëind Ëind', 'EVN Enertrag Kavarna' dhe 'Vertikal - Petkov & Cie', dhe 'Thracian Cliffs Golf & Spa Resort', në territorin e zonave të veçanta të mbrojtura në rajonet Kaliakra dhe Belite Skali përkatësisht, Republika e Bullgarisë nuk ka përmbushur detyrimet e saj në bazë të nenit 6 (2) të Direktivës së Këshillit 92/43/KEE të datës 21 maj 1992 për ruajtjen e habitave natyrore dhe të faunës dhe florës së egër;
- duke dështuar, së pari, për të vlerësuar si duhet efektin kumulativ të projekteve 'Windtech', 'Brestiom', 'Eco Energy' dhe 'Longman Investment' në territorin e zonës së rëndësishme të shpendëve që përfshin rajonin Kaliakra i cili nuk u klasifikua si zonë e veçantë për mbrojtje, megjithëse duhet të ishte cilësuar si e tillë, dhe, së dyti, duke autorizuar zbatimin e projektit 'Longman Investment', Republika e Bullgarisë nuk ka përmbushur detyrimet e saj sipas nenit 4 (2) dhe (3) të Direktivës 2011/92/BE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 13 dhjetorit 2011 për vlerësimin e efekteve të



disa projekteve publike dhe private mbi mjedisin dhe pikën 1 (b) të Shtojcës III të asaj direktive, dhe sipas nenit 2 (1) të asaj direktive, përkatësisht;<sup>5</sup>

#### **2.4. Komisioni Evropian paralajmëron Greqinë për mangësitë në mbrojtjen e natyrës<sup>6</sup>**

Komisioni Evropian paralajmëron në mënyrë të përsëritur Greqinë për dy dështime në zbatimin e legjislacionit të biodiversitetit në një mënyrë të pritshme. Greqia është dërguar më parë në gjykatë për mos përcaktimin e një numri të mjaftueshëm të zonave të mbrojtura për shpendët, dhe për mos sigurimin e mbrojtjes së duhur për ato zona që janë caktuar. Gjykata gjeti mangësi të shumta, shumica prej të cilave ende nuk janë zgjidhur. Dështimet e mëtejshme për të adresuar këto probleme mund të nënkuptojë një paraqitje tjetër në gjykatë dhe përfundimisht ndëshkim me sanksione financiare. Komisioneri i Mjedisit i BE, Janez Potočnik, u shpreh: *"Presioni mbi biodiversitetin e Evropës nuk ka qenë kurrë më intensiv. Të gjitha Shtetet Anëtare duhet të bëjnë çmos për të ruajtur habitatet tona natyrore. Greqia duhet të zbatojë plotësisht legjislacionin e Evropës Natura 2000 para se të jetë vonë."*

Pas përfundimit të një çështje që datonte nga viti 1998, Gjykata Evropiane e Drejtësisë vendosi kundër Greqisë më 25 tetor 2007 për dështimin e saj për të caktuar një numër të mjaftueshëm të Zonave të Veçanta të Mbrojtjes (ZVM) për shpendët e egër. Gjykata renditi mangësi të shumta dhe identifikoi dymbëdhjetë specie në nevojë të veçantë për mbrojtje më të fortë, duke përfshirë edhe Gypætus barbatus, një specie e rrezikuar dhe Shqiponja Perandorake (Aquila heliaca), një specie e përshkruar si e kërcënuar. Greqia më pas shtoi edhe 12 ZVM të tjera, duke e çuar numrin total në 163 të ZVM kombëtare, dhe caktoi zona të mjaftueshme për njërin prej llojeve të përmendur posaçërisht në vendimin e Gjykatës. Përkundër këtij përparimi të kufizuar, mbulimi i përgjithshëm mbetet shumë më pak se kërkesat e gjykatës. Rreth 32 Zonat e Rëndësishme të Shpendëve (IBA) ende nuk janë mbuluar nga ZVM-të, dhe mbulimi i 67 IBA-ve të tjera është i pamjaftueshëm dhe kufijtë do të duhen rishikuar. Prandaj Komisioni dërgoi një paralajmërim përfundimtar me shkrim për pasojat e mundshme të këtyre dështimeve, të cilat përfundimisht mund të përfshijnë një ndëshkim financiar për Greqinë.

Një paralajmërim i veçantë po dërgohet gjithashtu në lidhje me dështimin e tij për të vendosur dhe zbatuar një regjim ligjor koherent, specifik dhe të plotë i cili do të garantonte një menaxhim të qendrueshëm dhe një mbrojtje efikase të ZVM-ve që janë caktuar tashmë. Gjykata Evropiane vendosi kundër Greqisë në Dhjetor 2008, duke vënë në dukje se ajo me të vërtetë nuk po mbron ZVM-të ekzistuese në një mënyrë të përshtatshme. Një përparim i vogël është bërë që nga ajo kohë dhe Komisioni është i bindur për seriozitetin e shkeljes dhe vonesa nuk mund të vazhdojë. Prandaj, një paralajmërim me shkrim për pasojat e mundshme të mosrespektimit të aktvendimit u dërgua.

#### **2.5. Komisioni i kërkon Hungarisë të respektojë legjislacionin e BE-së për vlerësimet e ndikimit në mjedis<sup>7</sup>**

Komisioni Evropian i kërkoj Hungarisë që të përshtaste legjislacionin e saj kombëtar për vlerësimin e efekteve të projekteve në mjedis në përputhje me rregullat e BE-së. Me

<sup>5</sup><http://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?text=&docid=173520&pageIndex=0&doclang=en&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=1337115>

<sup>6</sup> [https://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-10-310\\_en.htm?locale=en](https://europa.eu/rapid/press-release_IP-10-310_en.htm?locale=en)

<sup>7</sup> [https://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-12-656\\_en.htm?locale=en](https://europa.eu/rapid/press-release_IP-12-656_en.htm?locale=en)



rekomandimin e Komisionerit të Mjedisit, Janez Potočnik, Komisioni dërgoi një mendim të arsyetuar për këtë çështje. Në mungesë të një përgjigje të kënaqshme brenda dy muajve, Komisioni mund ta dërgonte çështjen në Gjykatën Europiane të Drejtësisë.

Një objektiv themelor i Direktivës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (Direktiva e VNM) është të sigurojë që projektet që kanë të ngjarë, për shkak të natyrës, madhësisë ose vendndodhjes së tyre, të kenë efekte të rëndësishme në mjedis, t'i nënshtrohen një vlerësimi të ndikimit në mjedis. Në Hungari, Direktiva e VNM-së ishte implementuar gabimisht në ligjin kombëtar, veçanërisht në lidhje me procesin e shqyrtimit të projektit i cili përcakton nëse disa projekte të listuara në Shtojcën II të Direktivës duhet të kenë një VNM. Ligji hungarez vendosi disa kufij dhe kritere të përjashtimit të cilat nuk morën parasysh të gjitha kriteret përkatëse të përzgjedhjes të përcaktuara në Shtojcën III të Direktivës. Kjo rezultoi në një zbatim të kufizuar të Direktivës.

Kjo çështje u adresua fillimisht me një letër zyrtare njoftimi dërguar Hungarisë në maj 2009, e ndjekur nga një tjetër letër shtesë në janar 2010. Ndërkohë Hungaria ka miratuar një numër ndryshimesh legislative për të siguruar përpunimin me kërkesat e Direktivës. Komisioni i mirëpriti këto ndryshime, por vuri në dukje se mangësitë ende mbeshin në lidhje me shqyrtimin e një sërë projektesh.

### **III. PRAKTIKA GJYQËSORE NDËRKOMBËTARE**

#### **3.1. Gjykata e Lartë e Afrikës së Jugut shfuqizon ndërtimin e një miniere në Zonën e Mbrojtur të Mabolës.<sup>8</sup>**

Gjykata e Lartë e Gaeuteng-ut të Veriut anuloi vendimet e vitit 2016 të ish-Ministrit të Burimeve Minerale Zwane dhe Ministrit të ndjerë të Çështjeve Mjedisore Molewa për të lejuar zhvillimin e një miniere të re qymyri në Mjedisin e Mbrojtur Mabola pranë Wakkerstroom, Mpumalanga.

Çështja u ngrit nga koalicioni i tetë i organizatave të shoqërisë civile duke sfiduar një sërë autorizimish që kanë lejuar një minierë nëntokësore të qymyrit në një zonë strategjike të burimeve ujore dhe një Zone të Mbrojtur.

Mjedisi i Mbrojtur i Mabolës u deklarua sipas Aktit të Zonave të Mbrojtura në 2014 nga qeveria provinciale Mpumalanga si pjesë e deklarimit të më shumë se 70'000 hektarëve të zonës së mbrojtur në kullotat e Mpumalanga. Kjo pasoi vite kërkimi dhe planifikimi të gjerë nga një numër agjencish qeveritare, duke përfshirë Departamentin e Çështjeve Mjedisore, Institutin Kombëtar të Biodiversitetit të Afrikës së Jugut dhe Agjencinë e Turizmit dhe parqeve Mpumalanga.

Në vitin 2016, pa konsultim publik dhe pa njoftim për koalicionin, dy ministrat dhanë lejen e tyre për ndërtimin e një miniere të madhe qymyrguri 15-vjeçare brenda Mjedisit të Mbrojtur Mabola.

---

<sup>8</sup> <https://cer.org.za/wp-content/uploads/2018/11/Mabola-NEMPAA-Judgment-8-November-2018-1.pdf>

Gjykata anuloi lejen dhe ia ktheu vendimin dy ministrave për rishqyrtim, me arsyetimin se ministrat nuk i morën vendimet e tyre në mënyrë të hapur dhe transparente ose në një mënyrë që promovonte pjesëmarrjen e publikut, dhe se vendimet ishin rrjedhojë procedurale e padrejtë.

Gjykata kritikoi ministrat se u mbështetën në proceset e ndjekura nga vendimarrës të tjerë në vend që të ushtronin lirinë e tyre në mënyrë të pavarur sipas Ligjit për Zonat e Mbrojtura, duke iu referuar veçanërisht dështimit të tyre për të aplikuar një qasje paralajmëruese kur kanë të bëjnë me territor “të ndjeshëm”, të cënueshëm, shumë dinamikë ose “ekosisteme të stresuar” si “një abdikim i palejueshëm i autoritetit vendimarrës”.

Gjykata gjithashtu u shpreh se: *“Dështimi për të marrë parasysh përgjegjësitë ndërkombëtare të Afrikës së Jugut në lidhje me mjedisin dhe dështimi për të marrë parasysh se përdorimi dhe shfrytëzimi i burimeve natyrore të parinovueshme duhet të bëhet në një mënyrë të përgjegjshme dhe të barabartë, duhet të plotësojnë “nivelin më të lartë të shqyrtimit” të nevojshme kur diskutohet nëse aktivitetet minerare duhet të lejohen ose jo në një mjedis të mbrojtur. Dështime të tilla do të përbënin një shkelje nga shteti i detyrave të tij si një administrues i një mjedisi të pacenueshëm, veçanërisht kur është thënë se shumica e njerëzve do të pajtoheshin, kur mendojnë për të nesërmen e njerëzve të palindur, se është një detyrë morale aktuale për të shmangur shkaktimin e dëmit ndaj mjedisit”.*

Leja për këtë minierë e dhënë nga dy ministrat ishte e para në Afrikën e Jugut për një minierë të re që lejohej në një mjedis të mbrojtur. Earthlife Africa, Rrjeti i komunitetit të Minierave dhe Drejtësisë Mjedisore të Afrikës së Jugut, Trusti i Rrezikuar i Jetës së Egër, BirdLife Afrika e Jugut, Federata e Mjedisit të Qendrueshëm, Shoqata për Ujë dhe Zhvillim Rural, Fondacioni Bench Mark dhe GroundWork, e përfaqësuar nga Qendra për të Drejtat e Mjedisit, kundërshtuan vendimet ministrore për të lejuar funksionimin e kësaj miniere.

Gjykata urdhëroi që në rishqyrtimin e kërkesës për leje miniere, në Mjedisin e Mbrojtur Mabola, Ministrat udhëzohen që:

- Të marrë parasysh interesat e komuniteteve lokale dhe parimet mjedisore të referuara në seksionin 2 të Aktit Kombëtar të Mjedisit “me një masë të rreptë shqyrtimi”
- Të shtyjnë vendimet e tyre për rishqyrtim, derisa të jenë përcaktuar ankesat e Programit të Menaxhimit Mjedisor dhe Licencës së Përdorimit të Ujit
- Të mos japë leje, para se të jetë hartuar një plan menaxhimi i zonës së mbrojtur.

Gjykata e Lartë shprehu kritikën e saj për *“një tipar shqetësues në sjelljen e ministrave”* dhe miratoi parashtrimin e bërë nga avokati i koalicionit se: *“qeverisja dhe sjellja etike mjedisore përmirësohet thjesht duke e ekspozuar shkëlqimin e saj ndaj vëzhgimit publik. Ajo që rezultoi ishte një “largim i pajustificueshëm dhe i paarsyshëm nga urdhërimet ligjore dhe çoi në veprime administrative të padrejta procedurale”.*

Afrika e Jugut e ka pranuar prej kohësh se kullotat e Mpumalanga, KwaZulu-Natal dhe Free state janë tepër të rëndësishme për trashëgimninë natyrore të Afrikës së Jugut. Kullotat janë burime të rëndësishme ujore dhe shtëpia e një sërë sektorësh prodhimi që mbështesin zhvillimin ekonomik. Në rastin e Mabolës, Mjedisi i Mbrojtur bie brenda një zone strategjike të burimit

të ujit që ushqen disa nga lumenjtë më të mëdhenj të Afrikës së Jugut. Për më tepër, zonat e mbrojtura jo vetëm që ndihmojnë biodiversitetin e vendit, veçanërisht jetën e egër të pabesueshme dhe ekosistemeve të rëndësishme natyrore, por janë gjithashtu një pjesë kyçe e reputacionit të Afrikës së Jugut si një destinacion turistik global.

Ky gjykim është një fitore për drejtësinë mjedisore. Ne duam të shohim zonat e mbrojtura të pacenuara nga minierat, nga qeveria si kujdestare e mjedisit në emër të të gjithë amerikano-jugorëve. Kjo kujdestari cenohet nëse vendimet që kanë pasoja kaq të rëndësishme merren me dyer të mbyllura. MEJCON-SA është investuar thellësisht në çështjet e llogaridhënies. Ky gjykim përforcon rëndësinë themelore të vendimmarrjes së drejtë dhe transparente.

I konfirmon qeverisë dhe të gjithë zhvilluesve që propozojnë projekte shumë ndotëse në zonat e ndjeshme mjedisore në Afrikën e Jugut se duhet të tregohen rrethana të jashtëzakonshme për të justifikuar atë zhvillim të propozuar. Afrika e Jugut është një vend me mungesa të ujit dhe Mjedi i Mbrojtur i Mabolës, ku do të vendoset miniera e qymyrit, ka një rëndësi të veçantë hidrologjike për vendin në tërësi.

Vendimi i gjyktaës konfirmoi parimet themelore të ligjit të cilat u anashkaluan nga organet publike kur morën vendimet për të lejuar minierat në një zonë të mbrojtur.

### **3.2. Gjykata e Lartë e Indisë, urdhëron ruajtjen e distancës prej 1 km nga Parqet Kombëtare dhe vendet e mbrojtura të kafshëve të egra, nga ndërtimet**

Gjykata e Lartë në Neë Delhi, në Qershor 2022, urdhëroi që të gjitha Parqet Kombëtare dhe vendet e mbrojtura të kafshëve të egra në vend që bien nën pyllin e mbrojtur duhet të caktojnë një distancë minimale prej një kilometër si zonë eko-sensitive, ku aktivitetet e ndaluara të specifikuara nga Qendra, duke përfshirë minierat dhe ngritja e ndonjë strukture të re të përhershme nuk do lejohen.

Vendimi i gjykatës erdhi pas një sërë kërkesash të paraqitura dhe një kërkesë në pritje të paraqitur nga “TN Godavarma”, për miratim të vendimeve për mbrojtjen e burimeve pyjore.

Në këtë çështje, gjykata trajtoi aplikimet nga minatorët privatë dhe shtetet për përshkrimin e zonës eko sensitive, që rrethon strehimoret e kafshëve të egra dhe parqet kombëtare, një çështje në pritje në gjykatë që prej vitit 2003. Përveç kësaj, vendimi i gjykatës trajtoi gjithashtu çështjen e minierave në dhe rreth Jamua vendi i shenjtë i kafshëve të egra Ramgarh, i vendosur në Rajasthan.

Në vendim thuhet se: *“Ne urdhërojmë që çdo pyll i mbrojtur, që është Park Kombëtar ose vendstrehim i kafshëve të egra, duhet të ketë një zonë eko-sensitive prej të paktën një kilometër të matur nga kufiri i demarkuar i një pylli të tillë të mbrojtur në të cilin Aktivitetet e parashikuara në Udhëzimet e Ministrisë së Mjedisit Pyjeve dhe Ndryshimeve Klimatike (MMPNK) më 9 shkurt 2011 do të respektohen në mënyrë rigoroze.”*

Duke vënë në dukje rolin që duhet të luajë shteti në veprimin si administrues i besuar i burimeve natyrore më shumë sesa lehtësimi i aktivitetit ekonomik në pyje, në vendim thuhet se: *“Shteti*

*duhet të veprojë si administrues i besuar për të mirën e përgjithshme publike në lidhje me burimet natyrore në mënyrë që zhvillimi i qëndrueshëm mund të arrihet në afat të gjatë.”*

Në Vendim deklarohet më tej: *”Një rol i tillë i shtetit është më i rëndësishëm sot, se ndoshta në çdo moment të historisë, me kërcënimin e katastrofës klimatike që rezulton nga ngrohja globale që duket i madh.”*

Për shkak të kalimit të kohës, gjykata vuri në dukje se në dhjetor të 2006, Gjykata e Lartë në një çështje tjetër në lidhje me minierat Goas kishte miratuar një udhëzim për ruajtjen e zonës së sigurisë 10 kilometra të gjerë nga kufijtë, në lidhje me vendet shenjta dhe parqet kombëtare. Megjithatë, kjo nuk kishte të bënte me kufirin minimal për zonën eko sensitive.

Gjykata tha se urdhri aktual do të zbatohet në të gjitha shtetet ku minimumi i zonës eko sensitive nuk është i përshkruar. Megjithatë, në rast se ka shtete që kanë përshkruar zonën eko sensitive minimale përtej një kilometri, në atë rast vendimi thotë: *“Në rast, se zona eko sensitive është përshkruar tashmë sipas ligjit që shkon 1 kilometër përtej zonës, si zonë eko sensitive do të mbizotërojë diferenca më e gjerë.”*

Autoriteteve iu kërkua gjithashtu të shqyrtonjnë nevojën për zgjerimin e zonës eko sensitive në lidhje me çdo park kombëtar ose vend të shenjtë dhe të kërkojë miratimin nga gjykata pasi të konsultohet me shtetin përkatës, Qendrën ose Komitetin e Përhershëm të Bordit Kombëtar të Kafshëve të Egra.

Qendra, ndërsa doli me udhëzimet e shkurtit 2011 për zonën eko sensitive, kishte përshkruar një kufi prej 10 kilometrash bazuar në përgjigjet e marra nga shtetet. Gjykata ishte e vetëdijshme për faktin se një zonë eko sensitive uniforme për të gjitha parqet dhe vendet e shenjta kombëtare nuk do të ishte e realizueshme pasi vuri në dukje rastet e veçanta si Parku Kombëtar Sanjay Gandhi në Mumbai dhe Parku Kombëtar Guindy në Chennai, të cilat ndodhen shumë afër metropolit.

Edhe në rastin e Parkut Kombëtar Jamua Ramgarh, Qeveria e Rajasthan-it informoi Gjykatën e Lartë se mbajtja e zonës eko sensitive, prej 10 kilometrash nuk ishte e realizueshme dhe kërkoi përcaktimin e zonës eko sensitive për vendndodhjen specifike. Për të gjitha këto përjashtime, gjykata parashikoi se *“gjerësia minimale e zonës eko sensitive mund të zvogëlohet me interes të jashtëzakonshëm publik”*. Por për këtë qëllim, gjykata tha: *“Shteti në fjalë do t'i drejtohet Komitetit Qendror të fuqizuar nga gjykata dhe MMPNK-së dhe të dyja këto organe do të japin opinionet ose rekomandimet e tyre përkatëse përpara kësaj gjykate në bazë të të cilave kjo gjykatë do të miratojë urdhrin e duhur”*.

Sa i përket Jamua Ramgarh, gjykata miratoi një raport të autoritetit të nëntorit 2003, duke dhënë një *“pamje të tmerrshme”* se si minatorët privatë shkatërruan zonën e mbrojtur pyjore të shtrirë mbi 300 kilometra katrorë dhe u shpreh se norma e zonës eko sensitive prej 1 kilometër do të zbatohet për çdo aktivitet të ri, ndërsa për aktivitetet ekzistuese do të ruhej minimumi i zonës eko sensitive prej 500 metrash. Më tej, gjykata udhëzoi përcaktimin e sasisë së kompensimit për çdo minator që ka kryer aktivitetin minerar, brenda strehës së Jamua Ramgarh dhe të paraqesë një raport në katër muaj me rekomandime specifike për pyllëzimin kompensues, pastrimin e djerrinës dhe kompensimin për degradimin e burimeve pyjore.

Për më tepër gjykata urdhëroi Shefin e Ruajtësit të Pyjeve të çdo shteti që të paraqesë një raport në tre muaj në gjykatë, duke ofruar një listë të aktiviteteve që vazhdojnë në zonën ekosensitive

të çdo parku kombëtar ose vendstrehim të kafshëve të egra, duke marrë ndihmë nga qeveria për imazhe satelitore ose fotografinë duke përdorur drone.

Më tej, gjykata kërkoi të sigurohet që asnjë strukturë e re e përhershme të mos krijohet brenda zonës eko sensitive dhe ata që tashmë kryejnë ndonjë aktivitet do të duhet të aplikojnë për leje brenda gjashtë muajve.

### **3.3. Gjykata e Rondonia anuloi pakësimin dhe reduktimin e Rezervës Nxjerrëse Jaci Parana (Resex) dhe Parkun Shtetëror Guajara Mirim me 540'000 hektarë.**

I vendosur në Amazonën braziliane, shteti Rondonia ka promovuar një kryqëzatë të vërtetë për heqjen e gazit, zvogëlimin e zonave të mbrojtura në territorin e tij, duke favorizuar grabitjen e tokës dhe shpyllëzimin e paligjshëm.

Në korrik, Asambleja Legjislative ka votuar përmes një akt për heqjen e gazetës së Parkut Shtetëror Ilha da Flores dhe zvogëlimin e 16'000 hektarëve të Rezervës së Zhvillimit të Qëndrueshëm Limoeiro.

Krijimi i këtyrë dy zonave synonte të kompensonte zvogëlimet në Rezervatin Nxjerrës Jaci-Parana dhe Parkun Shtetëror Guajara-Mirim, objekt i çështjes së vendosur nga Gjykata Shtetërore.

Rondonia shkon në kundërshtim me atë që liderët botërorë po angazhohen, por shteti nuk është i vetëm. Proceset e zvogëlimit, degradimit dhe degazetimit të Zonave të Mbrojtura (të njohura me shkurtesën ZZMDD) janë gjithnjë e më të shpeshta në Brazil.

Sipas të dhënave nga platforma ZZMDD Tracker e WWF-Brazil, rreth 90 ngjarje nga PADDD kanë ndodhur në vend vitet e fundit, duke prekur më shumë se 41'000 milje katrorë, një zonë më e madhe se Portugalia.

Dekadën e kaluar, Kongresi Kombëtar dhe Asamblatë Shtetërore filluan të diskutojnë intensivisht disa projektligje për proceset e ZZMDD. Në përgjithësi, diskutimeve u mungon transparenca e duhur, mbështetja teknike dhe pjesëmarrja e shoqërisë civile.

Ndryshimet e propozuara reduktojnë pothuajse tërësisht statusin e mbrojtjes së këtyre zonave, duke kërcënuar biodiversitetin dhe shërbimet e ekosistemit.

Resex Jaci-Parana u krijua në 1996 me një dekret shtetëror dhe është bashkimi i disa plantacioneve të gomës të pushtuara që nga fillimi i shekullit të kaluar. Banorët tradicionalë u dëbuan nga pushtuesit, me denoncime për dhunë dhe detyrim.

Zvogëlimi i parkut Shtetëror Resex dhe Guajara-Mirim do të ndikojë drejtpërdrejt në Tokat Indigjene Uru-eu-wau-wau, Karipuna, Igarape Lage, Igarape Ribeirao, Karitiana, si dhe popujt që jetojnë në izolim vullnetar në rajon.

Të dhënat e fundit të zbuluara nga IKKH (Instituti Kombëtar për Kërkimet Hapësinore) vënë në dukje një shkallë në rritje të shpyllëzimit në Zonat e Mbrojtura brenda Amazon Legal, e cila

u hodh nga 424 milje katrorë në 2019 në 594 milje katrorë në 2021. Këto raportohen si indekset më të larta në seri matur nga instituti që nga viti 2008.

Pas një padie të ngritur për këtë çështje, në 22 Nëntor 2021 Gjykata e Rondonia anuloi njëzëri efektet e një ligji shtetëror që reduktoi Rezervën Nxjerrëse Jaci Parana (Resex) dhe Parkun Shtetëror Guajara Mirim me 541'000 hektarë. Qëllimi i ligjit ishte të legalizonte praninë e blegtorëve të paligjshëm në këto zona, duke përfshirë biznesmenë kryesorë, profesionistë liberalë dhe nëpunës civilë, të cilët kontrollojnë bagëtinë e më shumë se 100'000 bagëtime në Jaci-Parana Resex.

Ligji, i botuar në maj, shpërbleu “shpyllëzuesit” dhe hapi mundësinë e rrregullimit të tokave të pushtuara ilegalisht bazuar në veprime të dhunshme dhe të armatosura. Shpyllëzimi dhe mbarështimi i bagëtime janë shtytësit kryesorë për t'i kthyer këto zona (si shumë rajone të tjera në Amazon) në emetues karboni, gjë që përkeqëson ndryshimet klimatike.

Në vendimin e saj, Gjykata e Shtetit ka përcaktuar se Autoriteti Publik duhet të mbrojë dhe ruajë mjedisin dhe është i detyruar të krijojë dhe menaxhojë në mënyrë adekuate zonat e mbrojtura, në vend të legalizimit të pushtimeve të paligjshme dhe shkatërruese brenda atyre zonave.

Një tjetër pikë e theksuar është se zvogëlimi i zonave të mbrojtura nuk mund të kishte ndodhur pa kompensimin mjedisor, studime të thelluara teknike dhe konsultime falas, paraprake dhe të informuara me popullatat e prekura (veçanërisht popujt indigjenë, sipas Konventës 169 të ILO-së).

Tani, do të varet nga qeveria e shtetit të garantojë mbrojtjen e Parkut Shtetëror të Guajara Mirim dhe të largojë pushtuesit e Resex-it, si dhe të planifikojë dhe zbatojë restaurimin e zonave të degraduara.

Vitin e kaluar, Resex Jaci-Parana ishte zona e tretë e mbrojtur më e shpyllëzuar në vend, me më shumë se 38 milje katrorë pyll të shkatërruar. Vendimi i gjykatës rikthen mbrojtjen e zonave. Gjykata zbatoi të drejtat themelore të regjistruara në Kushtetutën Federale e shtetit të Rondonia.

Restaurimi i zonave të degraduara ilegalisht është teknikisht i mundshëm ekonomikisht dhe tërheqës nga pikpamja mjedisore për shtetin. Përveç uljes së karbonit dhe kontributit në zbutjen e ndryshimeve klimatike, studimet e fundit kanë treguar se agropylltaria (në përputhje me kategorinë Resex) në Amazonë është më fitimprurëse, sesa blegtoria apo dhe mbjellja e sojës.

Padia dhe vendimi i gjykatës, përbën një precedent të mirë dhe ofron jurisprudencë në një shtet që ka investuar në mënyrë drastike kundër Zonave të Mbrojtura.

### **3.4.Ndalimit i ndërtimit të HEC-eve në Parkun Kombëtar të Mavrovës**

Si zona më e pasur e Maqedonisë së Veriut në biodiversitet, Parku Kombëtar Mavrovo raprohet të jetë shtëpia e llojeve të ndryshme të faunës së mbrojtur rreptësisht nga Konventa e Bernës. Parku Kombëtar Mavrovo është një nga zonat e fundit ku është dëshmuar riprodhimi i

rrëqebullit jashtëzakonisht të rrallë të Ballkanit. Ndërtimi i hidrocentraleve dhe infrastruktura përkatëse do të shkatërronte një nga habitatet e tij të fundit. Rrëqebulli i Ballkanit është një specie e rrëqebullit euroaziatik dhe konsiderohet e rrezikuar në mënyrë kritike nga Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN). Përveç kësaj, parku kombëtar Mavrovo strehon më shumë se 1000 kafshë dhe rreth 1500 specie bimore dhe është një nga pikat e nxehta të biodiversitetit në Evropë. Midis tyre është Rrëqebulli i Ballkanit i rrezikuar në mënyrë kritike me një popullsi të mbetur prej 20-40 individësh.<sup>9</sup>

Pikërisht në territorin e këtij parku, në vitin 2010 qeveria maqedonase planifikoi ndërtimin e dy hidrocentraleve të mëdha - Boškov Most dhe Lukovo Pole - dhe 20 të vogla. Ndërsa Parku ka dy hidrocentrale të mëdhenj që janë në veprim që nga vitet 1950, të cilët ndikojnë në nivelin e ujit dhe jetën e egër në park. Shtimi i më shumë hidrocentraleve do të kishte një efekt shkatërrues në florën dhe faunën e brishtë të Mavrovës. Për të siguruar financimin e projekteve, u përfshinë dy investitorë ndërkombëtarë: Banka Botërore me një kredi 70 milion USD për Lukovo Pole dhe BERZH me një kredi 65 milion EUR për Boškov Most.

Përpara vendimit për dhënien e kredive duhej bërë një studim i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Sidoqoftë, në nëntor 2011 BERZH miratoi kredinë e saj përpara se të përfundonte procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Pas një ankese të menjëhershme nga organizata mjedisore, Mekanizmi i Ankesave për Projektin e BERZH konfirmoi në 2013 se banka kishte shkelur politikat e veta mjedisore dhe sociale.

Ndërkoh një ankese tjetër u paraqit në 2013 në Konventën e Bernës. Si përgjigje dhe pas hetimit të vet, më 4 dhjetor 2015, Kongresi i Bernës (një nga konventat më të rëndësishme të natyrës në Evropë) i bëri thirrje qeverisë maqedonase të ndalojë të gjitha projektet e ndërtimit brenda parkut kombëtar dhe të bëjë një vlerësim të gjerë të ndikimit në mjedis. Rekomandimet Berna i drejtoi gjithashtu tek financuesit ndërkombëtarë të projekteve të hidrocentraleve, veçanërisht te BERZH.

Pas këtij rekomandimi brenda të njëjtit muaj, Banka Botërore në 22 dhjetor 2015 tërhoqi fondet e saj për një nga dy projektet e mëdha të hidrocentraleve brenda Parkut Kombëtar Mavrovo në Maqedoninë e Veriut.

Ndërsa përpjekjet për të zhvilluar projektet e ndërtimit të HEC-eve nuk ndaluan, organizata mjedisore iu drejtuan gjykatës administrative vendase, e cila pranoi të shqyrtojë ankesën e paraqitur nga organizata maqedonase e mjedisit *Front 21/42* dhe shpalli të pavlefshme licencën për ndërtimin e projektit të hidrocentraleve. Sipas gjykatës Ministria e Mjedisit e kishte dhënë licencën në vitin 2012 në bazë të një vlerësimi jashtëzakonisht të papërshtatshëm dhe jo të plotë të ndikimit në mjedis dhe për këtë arsye ka shkelur ligjin ekzistues kombëtar të mjedisit. Një vlerësim i shëndoshë i ndikimeve mjedisore nuk u krye kurrë.

Pas akordimit të financimit për dy projektet e mëdha të hidrocentraleve në Parkun Kombëtar Mavrovo, Maqedoni, pasi Banka Botërore ishte tërhequr nga financimi i hidrocentralit 'Lukovo Pole' në dhjetor 2015, në 24 janar 2017 edhe BERZH (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim) deklaroi të dilte nga projekti "Boskov Most".

---

<sup>9</sup> <https://bankwatch.org/success-stories/saving-macedonia-s-mavrovo-national-park-and-the-balkan-lynx>



Kundërshtimi ndaj zhvillimit të hidrocentraleve në Mavrovo nuk ishte i kufizuar vetëm nga aktivitete të organizatave mjedisore. Në vitin 2014, banorët e Mavrovos dhe Dibrës, si dhe diaspora shqiptare organizuan protesta përpara zyrave të Bankës Botërore në të gjithë botën, duke kërkuar që projekti Lukovo Pole të rrëzohej. Dhe gati 200 shkencëtarë të njohur globalisht nënshkruan një peticion drejtuar Kryeministrit të Maqedonisë për të anuluar planet për hidrocentralet në Mavrovo. Siç rezultoi përpjekjet patën sukses së pari e tërheqjen e Bankës Botërore, më pas me pezullimin e huasë nga BERZH dhe më tej me tërheqjen tërësisht të BERZH.

Bankat e mëdha ndërkombëtare janë investitorët kryesorë të bumit të ndërtimit të hidrocentraleve në Ballkan, e cila kërcënon të shkatërrojë lumenjtë e fundit të paprekur të kontinentit tonë. Sipas një studimi të financuar nga organizata jofitimprurëse, Bankëatch, Banka Botërore, BERZH dhe Banka Evropiane e Investimeve (EIB) aktualisht janë duke financuar projekte hidrocentralesh me një total fondesh prej 818 milion €, duke rrezikuar rëndë 30 zona të mbrojtura siç janë parqet kombëtare dhe vendet e Nature 2000.<sup>10</sup>

### **3.5.Rasti i turbinave të erës pranë zonave të mbrojtura (Hungari)**

Në vitin 2012, një OJF mjedisore i kërkoi organizatës EMLA – Shoqata Hungareze e Menaxhimit të Mjedisit - që të niste një çështje ku zhvilluesi planifikonte të ndërtonte një seri centralesh ere prej 16 turbinash në afërsi të fshatrave Szeleste, Hegyfalva, Górház és Répceszentgyörgy në qarkun Vas, në veriperëndimin e Hungarisë. Në veri të vendndodhjes së projektit ishte një sit Natura 2000 ('Répce-mente' HUFH20010) i cili është habitat i Brumbullit të Madh Bricjap, Kunadhes së Stepës, Kastorit Euroaziatik, Barbastelas Perëndimore (lakuriq evropian), etj. Turbinat e planifikuara ishin rreth 250 metra larg zonave të veçanta të ruajtjes dhe 800 metra nga banesat e fshatrave. Faktorët më të rëndësishëm mjedisorë të përfshirë nga projekti ishin dëmtimi i peizazhit, bezdisja e specieve/habitateve të mbrojtura nga emetimi i zhurmës dhe dridhjes nga turbinat. Dokumentacioni i vlerësimit paraprak u dorëzua nga zhvilluesi në 2010 dhe shpjegoi se megjithëse vendndodhja e planifikuar e turbinave është afër vendeve të Natura 2000 dhe zonave të banuara, këto nuk do të ndikohen. Autoritetet mjedisore u pajtuan me zhvilluesin dhe miratuan rezolutën përfundimtare se projekti nuk do të ketë efekte domethënëse në mjedis, dhe ai mund të nisë pas marrjes së lejes së ndërtimit. Kështu nuk u bë një VNM.

Kërkesë padia u paraqit në vitin 2012, e cila argumentonte se habitatet e specieve të mbrojtura dhe zhurma e pritshme dhe dridhjet e turbinave nuk ishin konsideruar si duhet në dokumentacionin e vlerësimit paraprak. Mendimet e ekspertëve konfirmuan pretendimet se në bazë të dokumentacionit të paplotë autoriteti nuk ishte në gjendje të vlerësonte rëndësinë e ndikimeve të mundshme. Sipas ekspertëve, zona e prekur ishte e vlefshme për mbrojtjen e natyrës dhe peizazhit edhe pse ishte jashtë fushëveprimit të zonës së mbrojtur.

Në Shkurt 2017 Gjykata vendase e pranoi padinë dhe deklaroi se projekti do të ketë ndikime të konsiderueshme në mjedis, prandaj i shfuqizoi vendimet e autoriteteve. Gjykata theksoi se vlerësimi paraprak ishte i pamjaftueshëm në lidhje me vlerësimin e efekteve të dridhjeve dhe zhurmave, për më tepër ndikonte në peizazh. Gjykata urdhëroi autoritetin mjedisor që gjatë procedurës së rishqyrtimit të marrë parasysh faktorët e theksuar nga mendimet e ekspertëve.

---

<sup>10</sup> <https://www.balkanrivers.net/en/tags/mavrovo>

Rishqyrtimi u bë në vitin 2015, por zhvilluesi dhe autoriteti mjedisor përsëritën se nuk do të ketë ndonjë ndikim të rëndësishëm në mjedis. Këto akte u goditën sërish në rrugë gjyqësore në vitin 2016 pasi ishin shkelur rregullat e përgjithshme të procedurave administrative, si dhe dispozitat vendase për VNM.

Autoritetet nuk i ishin përmbajtur arsyetimit të vendimit të gjykatës, duke injoruar argumentet e paditësve për emetimin e zhurmës dhe dridhjeve që shqetësonin natyrën dhe speciet në zonat e mbrojtura.

Gjatë gjykimit të dytë, eksperti i emetimit të zhurmës deklaroi qartë se zhurma do të jetë domethënëse për zonën në fjalë. Gjykata e pranoi padinë duke urdhëruar të kryhej një VNM e plotë për projektin.

Autoriteti dhe zhvilluesi kundërshtuan vendimin e gjykatës, por vendimi u la në fuqi.

Duhet theksuar se para vitit 2016, ligji hungarez nuk parashikonte ndonjë dispozitë në lidhje me distancën minimale midis turbinave me erë dhe zonave të ndërtuara. Sidoqoftë, në vitin 2016 hynë në fuqi një sërë rregullash të reja që ndaluan ndërtimin e turbinave me erë në një rreze prej 12.000 metrash nga zonat e banuara apo të mbrojtura. Kjo dispozitë e re zbatohet në procedurat e nisura ose të përsëritura pas hyrjes në fuqi, prandaj, realizimi i projektit në fjalë nuk ishte më i mundur, pasi turbinat ishin planifikuar të vendoseshin në një distance shumë më të vogël nga zonat dhe vendbanimet e përmendura.

## **IV. PRAKTIKA VENDASE NË MBROJTJE TË ZONAVE TË MBROJTURA**

### ***4.1. Cështja e rishikimit të kufijve dhe statusit të Zonave të Mbrojtura***

Në vitin 2019 nisi projekti për rishikimin e Zonave të Mbrojtura, i cili përfundoi me tre vendime të Këshillit të Ministrave në vitin 2021, të cilat parashikonin rishikim të kufijve të Parqeve Kombëtare; Parqeve natyrore dhe Zonës Vjosë Nartë.

Projekti u prezantua zyrtarisht si një iniciativë e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura e nisur për të saktësuar kufijtë e zonave të mbrojtura dhe me këtë rast për të rishikuar mundësinë e pakësimit apo shtimit të zonave të mbrojtura dhe në ndonjë rats rishikimin e statusit të tyre.

Sic është raportuar që në fillim të procesit, nga organizata të shoqërisë civile një pjesë e mirë e zonave të mbrojtura iu hoq mbrojtja dhe këto janë zona me interes të lartë për zhvillim, pranë bregdetit.

Rishikimi i zonave të mbrojtura duhet të bëhet sipas disa kriterëve ligjore të parashikuara nga ligji për zonat e mbrojtura, konkretisht neni 35 dhe 36 i ligjit të cilat parashikojnë respektivisht:

#### **1. Neni 35**

*Heqja dhe ndryshimi i statusit të zonës së mbrojtur*

*1. Një zone të mbrojtur i hiqet ose i ndryshohet statusi i mbrojtjes, sipas këtij ligji, kur kanë ndryshuar rrethanat dhe qëllimi për të cilat ajo e fitoi këtë status.*

*2. Heqja e statusit të një zone të mbrojtur kombëtare bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit, pas marrjes së mendimit nga ministria/ministritë*

*që mund të ketë/kenë propozuar heqjen ose ndryshimin e statusit nga bashkia, ekspertë të florës dhe faunës, institucionet kërkimore-shkencore, shoqëria civile dhe nga pronarët privatë kur në zonën e mbrojtur janë përfshirë edhe pronat e tyre, si dhe nga subjektet që kryejnë veprimtari në zonë, të pajisur me leje mjedisi.*

*3. Në propozimin për heqjen e statusit të një zone të mbrojtur mjedisore përfshihen:*

*a) argumentimi për heqjen e statusit;*

*b) vlerësimi i ndikimit në mjedis, që pasqyron ndikimin në kategorizimin ekzistues të zonës së mbrojtur në biodiversitetin dhe në popullatat ose bashkësitë vendore;*

*c) përshkrimi i masave zbutëse;*

*ç) rezultatet e proceseve të bashkërendimit dhe këshillimit me grupet e interesit të shoqërisë civile, veçanërisht me popullatat ose bashkësitë brenda dhe përreth zonës së mbrojtur, duke përfshirë një përmbledhje të komenteve të marra dhe reflektimin në propozim.*

## **2. Neni 36**

*Ndryshimi i sipërfaqes*

*1. Miratimi i ndryshimit të sipërfaqes së zonës së mbrojtur mjedisore, zgjerimi ose pakësimi i saj bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit ku argumentohet nevoja e ndryshimit konkret që do të përmirësojë rrjetin dhe mbrojtjen e zonës pas vendimit të KKT-së për ndryshimin e sipërfaqes së zonës së mbrojtur mjedisore.*

*2. Propozimi për ndryshimin e sipërfaqes së zonës konsultohet paraprakisht me komunitetin vendas, me pronarët, pronat e të cilëve, sipas rastit, përfshihen ose hiqen nga sipërfaqja e zonës, me subjektet që ushtrojnë veprimtari brenda zonës, me institucionet shkencore, me organet e qeverisjes vendore ku shtrihet zona dhe argumenton nevojën e ndryshimit.*

Përveç parashikimeve konkrete të mësipërme, gjatë rishikimit të kufijve është e rëndësishme të konsiderohen edhe kriteret që një zonë duhet të përmbushë për t'u konsideruar e vlefshme për t'u mbrojtur. Këto kriterë shkencore sipas parashikimit të nenit 11 të ligjit për zonat e mbrojtura janë:

a) të ketë diversitet të lartë të llojeve dhe/ose të habitateve;

b) të ketë dendësi të ulët të llojeve dhe/ose habitateve;

c) të ketë përfaqësueshmëri; ç) të ketë minimumin kritik të madhësisë së ekosistemit;

d) të ketë natyralitet, trashëgimi dhe integritet;

dh) të ketë vlera shkencore;

e) të karakterizohet nga prekshmëria ekologjike/ llojet e prekshme;

ë) të karakterizohet nga papërsëritshmëria/llojet endemike;

f) ka rrezikshmëri të lartë të kërcënohet nga ndërhyrjet e veprimtarive njerëzore;

g) mund të ofrojë mundësi për ruajtjen e jetës së egër.”

Procesi i rishikimit ët kufijve të zonave të mbrojtura nuk respektoi kërkesat ligjore më sipër, ndaj 11 organizata mjedisore, të drejtura nga shoqata ornitologjike shqiptare “AOS” iu drejtuan gjykatës me kërkesë apdi për shfuqizimin e vendimeve të rishikimit të kufijve të parqeve kombëtare dhe parqeve natyrore, në pjesën e pakësimit të zonave të mbrojtura. Cështjet janë duke u shqyrtuar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Paralelisht me këto dy procese, është duke u shqyrtuar në të njëjtën gjykatë edhe padia për rishikimin e kufijve të zonës Vjosë Nartë.

Disa prej arsyeve pse organizatat mjedisore kërkuar me këmbëngulje ruajtjen të paprekur të zonave që pakësoheshin me këto vendimarrje gjenden në vijim:

1. Në këto zonë janë regjistruar një numër i madh specimesh të egra, të listuara me status kërcënimi në Listën e Kuqe të Shqipërisë, miratuar me Urdhërin nr. 1280, datë 20.11.2013 të Ministrit të Mjedisit “Për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës së egër”<sup>11</sup>. Nga llojet e shpendëve të identifikuar, mbi 100 lloje janë të listuar në shtojcën II të Konventës së Bernës, ku listohen të gjitha llojet e kafshëve për të cilat kërkohet mbrojtje e veçantë, si dhe në Shtojcën I të Rrjetit të Zonave me Interes të Veçantë Ruajtjeje (Rrjeti Emerald). Në këtë Shtojcë listohen të gjitha llojet që kërkojnë marrjen e masave të veçanta për mbrojtjen e habitatit të tyre.<sup>12</sup> Lista e shpendëve veçanërisht vulnerabël është miratuar me Urdhërin nr. 62, datë 4.4.2016 “Për miratimin e listës së llojeve të shpendëve të egër, veçanërisht vulnerabël”<sup>13</sup>
2. Gjithashtu, të paktën 7 lloje janë të listuar në Shtojcën I të Konventës për Llojet Shtegtare (CMS), ku listohen llojet shtegtare, popullatat e të cilave vlerësohen të jenë në rrezik zhdukje në një pjesë apo në të gjithë hapësirën e shpërndarjes së tyre. Po në kuadër të kësaj konvente, Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen për Ruajtjen e Shpendëve të Ujit të Afrikës dhe Euroazisë (AEWA), e cila vepron për rreth 100 prej llojeve të gjendura në zonat e mbrojtura të prekura nga vendimet objekt padie, duke kushtëzuar vendin tonë të mbajë apo krijojë kushte të mira habitatit për këto lloje.
3. Për sa i përket gjendjes së popullatës së llojeve në Bashkimin Evropian, 23 lloje janë me interes të veçantë ruajtjeje pasi popullatat e tyre kanë hyrë në njërin prej kufijve të rrezikut sipas Bashkësisë Ndërkombëtare të Ruajtjes së Natyrës (IUCN).
4. Në nivel ndërkombëtar, 62 lloje janë të listuar në Shtojcën 1 të Direktivës Evropiane të Shpendëve (Direktiva 2009/147/EC<sup>14</sup>), që detyron vendet anëtare dhe ato vende që kanë nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit me Bashkimin Evropian apo kanë marrë statusin e vendit kandidat, të shpallin Zona të Posaçme Mbrojtjeje (SPA) për këto lloje.
5. Zonat ligatinore të bregdetit janë vendflezimet më të rëndësishme në Shqipëri dhe ndër më të rëndësishmit në Evropë për disa lloje të rendit të baltakëve (*Charadriiformes*). Mund të përmendet këtu rasti i sqepbizës (*Recurvirostra avosetta*). Zonat ligatinore mbartin rregullisht një përqindje të lartë të popullatave të dy llojeve të rajonit të Mesdheut dhe Detit të Zi, si pelikani kaçurrel (*Pelecanus crispus*) dhe flamingoja (*Phoenicopterus roseus*).
6. Këto zonë përfaqësojnë segmente të rëndësishëm të korridorit të shtegtimit të Adriatikut, ku qindra mijëra shpendë gjejnë ushqim dhe strehë gjatë sezoneve të shtegtimit. Një pjesë e këtyre shpendëve, si për shembull pelikanët, çafkat, pulëbardhat, flamingoja etj, në këtë zonë hasen me shumicë dhe gjatë gjithë vitit.

<sup>11</sup> Urdhër nr. 1280, datë 20.11.2013 të Ministrit të Mjedisit “Për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës së egër”, FZ nr. 197, datë 18.12.2013.

<sup>12</sup> Listë e zogjve dhe gjetarëve prezentë në peisazhin e mbrojtur Vjosë – Nartë referuar sipas Shtojcave të Konventës të Bernës, pjesë e çështjes nr. No. 2016/5 të iniciuar nga Konventa e Bernës me kërkesë të Eco Albania (<https://rm.coe.int/presumed-negative-impact-of-hydro-poer-plant-development-on-the-vjosa/1680933b64>), fq. 5

<sup>13</sup> Urdhër nr. 62, datë 4.4.2016 i Ministrit të Mjedisit “Për miratimin e listës së llojeve të shpendëve të egër, veçanërisht vulnerabël”, FZ. Nr. 70, datë 24.04.2016

<sup>14</sup> Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32009L0147>

7. Ndërsa këto pjesë të ZM që hiqen do të jenë sipërfaqe të destinuara për zhvillime urbane ose teknologjike, ndërsa zhvillimi kontraston me angazhimin e shtetit shqiptar për zgjerim të ZM-ve aktuale që rjedh nga anëtarësimi i Shqipërisë në konventa të ndryshme ndërkombëtare, nga Strategjitë dhe miratimi i ligjeve të posaçëm që rregullojnë fushën në fjalë, të cilat analizohen në mënyrë të detajuar te kapitulli i analizës juridike.

Nga ana tjetër i gjithë procesi i pakësimit të zonave të mbrojtura u zhvillua pa respektuar ansjë kriter ligjor, e këto argumenta iu parashtruan gjykatës, ndër më të rëndësishmet në formë të përmbledhur janë:

1. Ndryshimet nuk mbështeten në një PDZRK, sipas ligjit nr 81/2017 “Për zonat e Mbrojtura”. Rrjeti i Zonave të Mbrojtura gëzon statusin e zonës me rëndësi kombëtare, sipas përkufizimit të dhënë në nenin 3, pika 19 e ligjit 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, për këtë arsye ndryshimi i kufijve të zonave të mbrojtura apo i statusit të tyre duhet të paraprihej nga Plani i Detajuar për Zonën me Rëndësi Kombëtare (PDZRK), i cili është detyrim ligjor sipas parashikimit të nenit 7, pika 1 (c) dhe 18 të ligjit “Për zhvillimin e territorit”. Ky plan nuk është miratuar në kohën e daljes së akteve objekt padie.
2. Janë miratuar në mungesë të një Vlerësimi Strategjik Mjedisor, në kundërshtim me ligjin nr.107/2014 për “Planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe ligjin nr. 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”
3. Nuk janë në përputhje me ligjin për mbrojtjen e biodiversitetit dhe Strategjisë Kombëtare për Biodiversitetin.
4. Nuk janë në përputhje me planet e zhvillimit, (PPK; PPV) sipas legjislacionit për zhvillimin e territorit. Këto plane nuk parashikojnë heqje të sipërfaqeve, heqje të statusit të ZM-së, apo ulje statusi në përgjithësi për ZM-të, përfshirë rastin konkret.
5. Rrjeti i zonave të mbrojtura, në zvogëlim të sipërfaqeve dhe fragmentarizim të tyre, bien ndesh me Vlerësimet Strategjike, respektivisht të Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe Planit të Integruar të Bregdetit.
6. Nuk kanë respektuar pothuajse asnjë kërkesë materiale dhe/ose procedurale që kërkon Ligji për Zonat e Mbrojtura dhe Ligji për Mbrojtjen e Biodiversitetit
7. Ndryshimet në status dhe sipërfaqe të Zonave të Mbrojtura, nuk janë mbështetur dhe as nuk referojnë në Planin Specifik të tërësisë së zonave të mbrojtura
8. Procedura administrative për ndryshimin e kufijve të zonave të mbrojtura dhe zonimin e tyre, nuk është iniciuar nga autoriteti publik që e ka për kompetencë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, por nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.
9. Procedura administrative për ndryshimin e sipërfaqes së zonave të mbrojtura, shtimin, apo zvogëlimin e tyre, si dhe zonimi i secilës zonë, është procedurë administrative e mëvetshme dhe nuk mund të bëhet në tërësi për të gjithë territorin.
10. Aktet administrative nuk i janë nënshtruar Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, duke shkelur Ligjin Nr. 10440/2011 “Për VNM” Nisur nga rëndësia e zonave të mbrojtura, të cilat ligji i konsideron pasuri kombëtare (neni 3 i ligjit për zonat e mbrojtura) në nivel kombëtar e ndërkombëtar dhe ndjeshmërisë ekologjike, do të ishte dashur që për çdo

zonë, sipërfaja e të cilës prekej, të shoqërohej me një VNM, ku të përfshihej dhe konsiderohej konsultimi dhe shqyrtimi nga autoritetet, të studimeve të dedikuara mbi vlerat thelbësore të mjedisit dhe të biodiversitetit.

11. Konsultimi me publikun, OJF-të, institucionet shkencore nuk është kryer, në kundërshtim me ligjin për Zonat e Mbrojtura, Ligjin për Mjedisin, Ligjin për Biodiversitetin, Ligjin për VNM dhe Ligjin për VSM.
12. Nuk është kryer procesi i “Vlerësimit të duhur”, i njohur nga Direktiva BE për VNM si “Appropriate Assessment”, siç kërkohet nga Ligji për VNM, për një zonë të rëndësishë së veçantë
13. I gjithë procesi i rishikimit të kufinjve të ZM-ve është mbështetur në dokumentin “Vlerësimi për rishikimin e zonave të mbrojtura”, i cili nuk përmbush kriteret e përcaktuara nga ligji për mbrojtjen e mjedisit, ligji për VNM, ligji për zonat e mbrojtura, ligji për biodiversitetin dhe vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të tyre.
14. Procesi i miratimit të VKM-së objekt padie nuk ka respektuar kërkesat formale të aktit administrativ: Mosrespektimi i procedurave administrative dhe mungesa e qëllimit legjitim, mosarsyëtimi i VKM sjell cenim të sigurisë juridike dhe nenit 100 të Kodit të Procedurës Administrative.
15. Mendimet e dhëna nga Ministria e Drejtësisë nuk janë marrë parasysh dhe për më keq justifikohen përmes fakteve të pavërteta se janë reflektuar

## **V. NË VEND TË KONKLUZIONEVE**

Praktika gjyqësore në mbrojtje të zonave të mbrojtura është e varfër, ndërsa vendimarrja publike në favor të zhvillimit ekonomik dhe cenimit të këtyre zonave është në rritje.

Në këto kushte lind si domosdoshmëri sfidimi i vendimarrjeve publike që cenojnë këto zona në rrugë gjyqësore, si pushteti i vetëm që mund të anulojë apo rishikojë vendimet e pushtetit ekzekutiv. Këto procese mund të nisen nga organizata të shoqërisë civile.

## **VI. BIBLIOGRAFIA**

### **I. Raste studimi nga praktika të BE**

1. Komisioni Evropian i kërkon Hungarisë dhe Rumanisë të sigurojnë mbrojtjen e habitateve të jetës së egër.
2. Komisioni Evropian i kërkon Maltës respektimin e Direktivës së Shpendëve
3. Komisioni Evropian dërgon Bullgarinë në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë për dështim në mbrojtjen e specieve në rrezik zhdukjeje
4. Komisioni Evropian paralajmëron Greqinë për mangësitë në mbrojtjen e natyrës
5. Komisioni i kërkon Hungarisë të respektojë legjislacionin e BE-së për vlerësimet e ndikimit në mjedis

### **II. Raste studimi nga praktika ndërkombëtare**

1. Gjykata e Lartë e Afrikës së Jugut, mbron parkun kombëtar të Mabolës nga ndërtimi i një miniere
2. Gjykata e Lartë e Indisë urdhëron ndalimin e ndërtimeve me efekt negativ në mjedis 1 km larg Parqeve Kombëtare dhe zonave ku jetojnë kafshët e egra
3. Gjykata e Lartë e Rondonias anuloi pakësimin dhe reduktimin e Rezervës Nxjerrëse Jaci Parana (Resex) dhe Parkun Shtetëror Guajara Mirim.
4. Ndalimi i ndërtimit të HEC-eve në Parkun Kombëtar të Mavrovës, nga Gjykata administrative.
5. Ndalimi i ndërtimit të turbinave të erës pranë zonave të mbrojtura (Hungari)

\* \* \*

Res Publica, Nëntor 2023